



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT**

Nr. 1464 Prot.

Tiranë, më 07.10. 2024

**V E N D I M**

**Nr.5, datë 27.9.2024**

**PËR**

**“MIRATIMIN E OBJEKTIVAVE PËR MENAXHIMIN E RISQEVE NGA PËRMBYTJET, BASENI LUMOR ISHËM”**

Në mbështetje të Kreut 3, të Shtojcës III, të vendimit nr.1015, datë 16.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të burimeve ujore, të planeve të menaxhimit të baseneve ujore dhe planeve të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet”, paragrafit “vii”, të shkronjës “b”, të pikës 1, të kreut III, të vendimit nr.221, datë 26.4.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Kombëtar i Ujit

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e Objektivave për Menaxhimin e Risqeve nga Përmbytjet, Baseni Lumor Ishëm, me qëllim reduktimin e pasojave të mundshme negative nga përmbytjet për shëndetin e njeriut, mjedisin, trashëgiminë kulturore dhe aktivitetin ekonomik, si më poshtë:
  - a. Shmangia e risqeve të reja;
  - b. Zvogëlimi i risqeve ekzistuese;
  - c. Zvogëlimi i pasojave negative gjatë dhe pas një ngjarjeje përmbytjeje, forcimi i aftësisë ripërtëritëse;

- d. Përmirësimi i organizimit dhe kapaciteteve të menaxhimit të riskut nga përmbytjet, ndërgjegjësimi.
- Objektivat, së bashku me objektivat specifike në funksion të tyre, janë pjesë e Projektplanit të Menaxhimit të Riskut nga Përmbytjet, Baseni Lumor Ishëm, i cili përfshin masat konkrete që duhet të zbatohen për arritjen e objektivave.
  - Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, për monitorimin dhe vlerësimin periodik dhe përfundimtar të përmbushjes së objektivave, gjatë fazës së zbatimit të Planit të Menaxhimit të Riskut nga Përmbytjet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**BELINDA BALEBUKU**



**AGJENCIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE  
DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

**GERDA EUBONJA**

